

LegalNews

June 2020
Qershor 2020



I. Ligj nr. 43/2020 "Për aktivitetet e turizmit detar"

Kuvendi i Shqipërisë me datë 23.04.2020 ka miratuar ligjin nr. 43/2020 "Për aktivitetet e turizmit detar" (në vijim referuar si "**Ligji**").

Ligji është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 118 me datë 24.06.2020 dhe ka hyrë në fuqi më datë 09.07.2020.

Ligji ka për qëllim përcaktimin e rregullave, kushteve dhe kriterëve për aktivitetet e turizmit detar, i mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtim, infrastrukturës së nevojshme për ushtrimin e tyre dhe përcaktimin e përgjegjësive institucionale për këtë fushë në Republikën e Shqipërisë.

Dispozitat e Ligjit zbatohen për:

- a. aktivitetet e turizmit detar që zhvillohen përgjatë vijës bregdetare, hapësirës detare dhe në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë nga persona fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj;
- b. individë, vendas apo të huaj, të cilët kryejnë lundrime për qëllime turistike dhe argëtim me mjetet e tyre lundruese ose të marra me qira në hapësirën detare dhe në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë;
- c. mjetet lundruese vendase dhe të huaja, të cilat kërkojnë të hyjnë, të qëndrojnë, të lundrojnë dhe/apo të përdorin hapësirën detare shqiptare për qëllime private apo tregtare në fushën e aktiviteteve të turizmit detar.

I. Law no. 43/2020 "On maritime tourism activities"

The Parliament of Albania on 23.04.2020 has approved the law no. 43/2020 "On maritime tourism activities" (hereinafter, the "**Law**").

The Law was published with the Official Gazette no. 118, dated 24.06.2020 and has entered into force on 09.07.2020.

The Law aims to define the rules, conditions and criteria for maritime tourism activities, of vessels for touristic and entertainment purposes, the necessary infrastructure for their exercise and the definition of institutional responsibilities for this field in the Republic of Albania.

The provisions of the Law apply to:

- a. maritime tourism activities that take place along the coastline, maritime space and in the inland waters of the Republic of Albania by natural and legal persons, local and foreign;
- b. individuals, local or foreign, who sail for tourist purposes and entertainment with their vessels or rented ones in the maritime space and in the inland waters of the Republic of Albania;
- c. local and foreign vessels, which seek to enter, stay, sail and/or use the Albanian maritime space for private or commercial purposes in the field of maritime tourism activities.

Ligji përcakton subjektet që mund të ofrojnë aktivitetet e turizmit detar, përgjegjësitë e tyre në mënyrën e ofrimit të shërbimeve dhe në rastet e mosrespektimit të rregullave për ofrimin e shërbimeve.

Gjithashtu, në Ligj parashikohet ministria përgjegjëse për turizmin, në bashkëpunim me autoritete të tjera përkatëse, si organ kompetent për përcaktimin e zonave të ushtrimit të aktiviteteve të turizmit, kriteret, në bazë të të cilave ky organ duhet t'i përcaktojë këto zona, si dhe përcaktohen kushtet, në të cilat subjektet mund të ushtrojnë aktivitete turistike.

Ligji bën kategorizimin e mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi dhe parashikon mënyrën e përdorimit të tyre duke i ndarë në:

- kroçera;
- jahte;
- mjete të tjera të vogla lundruese.

Kusht i domosdoshëm është regjistrimi i këtyre mjeteve në regjistrin e mjeteve lundruese detare dhe specifikimi që kur regjistrohen për herë të parë, vetëm për qëllime tregtare, këto mjete duhet të plotësojnë disa kriteret që lidhen me:

- moshën e mjetit;
- certifikatën e lundrimit të sigurt nga shoqëria klasifikuese;
- policën e sigurimit brenda periudhës së vlefshmërisë, që garanton jetën e shëndetin e klientëve;
- përgjegjësitë për dëmet që u shkaktohen të tretëve.

The Law defines the entities that may provide maritime tourism activities, their responsibilities in the way of providing services and in cases of non-compliance with the rules for the provision of services.

Furthermore, the Law provides for the ministry responsible for tourism, in collaboration with other relevant authorities, as the competent authority for determining the areas of exercise of tourism activities, the criteria on the basis of which this authority should define these areas, as well as the conditions under which entities can exercise tourist activities.

The Law categorizes vessels for touristic and entertainment purposes and provides for their use by dividing them into:

- cruises;
- yachts;
- other small vessels.

A necessary condition is the registration of these vessels with the register of maritime vessels and the specification that when they are registered for the first time, only for commercial purposes, these vessels must meet certain criteria related to:

- age of the vessel;
- safe navigation certificate from the classification company;
- insurance policy within the period of validity, which guarantees the life and health of customers;
- liability for damages caused to third parties.

Më tej, Ligji bën parashikime për llojet e tjera të mjeteve lundruese, për hyrjen dhe qëndrimin në ujërat shqiptare të kroçerave, përcaktimin e mjeteve të tjera turistike, të cilat mund të lundrojnë në ujërat shqiptare, si dhe llojet e kontratave që mund të lidhen me qëllim realizimin e aktiviteteve të turizmit detar.

Në lidhje me përdorimin e hapësirës detare për aktivitetet turistike, që zhvillohen nga mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi, përcaktohen mënyrat, kushtet, kriteret, afatet për hyrjen, daljen dhe qëndrimin në ujërat territoriale shqiptare të mjeteve të lundrimit, me qëllim ofrimin e garancive përkatëse për lundrimin në ujërat shqiptare, por edhe për garantimin e sigurisë në det.

Ligji parashikon dhe sanksionet e zbatueshme ndaj subjekteve, si dhe të drejtën e ankimit administrativ lidhur me sanksionet e vendosura.

Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës për turizmin do të nxjerrin aktet nënligjore të përcaktuara në Ligj brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Further, the Law makes provisions for other types of vessels, for entry and stay into the Albanian waters of cruises, determination of other touristic vessels, which can sail into Albanian waters, as well as the types of contracts that may be related to purpose of carrying out maritime tourism.

Regarding the use of maritime space for touristic activities, which are carried out by vessels for touristic and entertainment purposes, the ways, conditions, criteria, deadlines for entry, exit and stay into the Albanian territorial waters of the vessels are determined, in order to provide the relevant guarantees for navigation into Albanian waters, but also for guarantying the safety at sea.

The Law determines also the applicable sanctions for entities, as well as the right to administrative appeal regarding the sanctions imposed.

The Council of Ministers and the Minister responsible for tourism are authorized to enact the sub-legal acts, defined in the Law within 6 months from its entry into force.

Deloitte Contacts

Olindo Shehu, CPA
Partner | Tax & Legal Services
Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Faik Konica",
Ndërtesa nr.6, Hyrja nr. 7
1010, Tirana, Albania
Mob: +355 68 60 33 116
E-mail: oshehu@deloitteCE.com

Sabina Lalaj
Local Legal Partner
Deloitte Legal sh.p.k

Rr. "Faik Konica",
Ndërtesa nr.6, Hyrja nr. 7
1010, Tirana, Albania
Mobile: + 355 68 37 33 130
E-mail: slalaj@deloitteCE.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 312,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.